



Prishtinë: 28.06.2013

Kodi i ZRRE-së: V\_549\_2013

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_933\_04\_13**;
- Ankesa e KEK-ut e datës 31.05.2013

### në seancën e mbajtur më datë 28 qershor 2013, nxorri këtë:

## V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin Xh.C, (shifra e konsumatorit: DPR - 2001084) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_933\_04\_13 i datës 29.04.2013.

## Arsyetim

Konsumatori me shifër DPR – 2001084 me datë 16.10.2007, 24.09.2008, 02.12.2009 dhe 13.04.2011 ka parashtruar ankesën në KEK duke kundërshtuar faturat e energjisë elektrike 09/2007, 01/2008, 06/2008, 02/2009 dhe 12/2010.

Departamenti i faturimit në KEK me datë 25.03.2008 ka korrigjuar vlerën prej (-30.82€), me datë 04.03.2009 ka korrigjuar vlerën prej (-41.62€), me datë 17.06.2011 ka korrigjuar vlerën prej (-6.36€).

Me datë 17.03.2011 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë dalur te konsumatori me shifër DPR – 2001084 ku kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë larguar nga matja njehsorin nr. 202199 TIM Kosova me gjendje: TL=16543 kW dhe TU=17711 kW dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 47550054 me gjendje TL=0 kW dh TU=0 kW.

Me datë 07.03.2013 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së pasi që KEK-u nuk i ka kthyer përgjigje konsumatorit në ankesat e parashtruar në KEK.

DMK pas ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës së dhe me datë 29.04.2013 ka nxjerr vendim duke **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që: **1**) të shkarkoj konsumatorin me shifër DPR – 2001084 nga faturat: nr. 09070DPR-2001084 të datës 10.10.2007 në vlerë 184.80€ (09/2007), nr. 06080DPR-2001084 të datës 10.07.2008 në vlerë prej 181.37€ (06/2008), nr. 02090DPR-2001084 të datës 04.03.2009 në vlerë pre 251.46€ (02/2009), nr. 12100DPR-2001084 të datës 08.01.2011 në vlerë pre 509.18€ (12/2010); dhe **2**) për faturat 09/2007 dhe 06/2008 ta ngarkoj konsumatorin me mesataren e shpenzimeve mujore të sezonës verore me njehsorin e vjetër elektrik nr. 2002199 (04/2010 – 09/2010) që është 345 kWh/muaj, ndërsa për



faturat 02/2009 dhe 12/2010 ta ngarkoj konsumatorin me mesataren e shpenzimeve mujore të sezonës dimërore me njehsorin e vjetër elektrik nr. 2002199 (10/2009 – 03/2010) që është 418 kWh/muaj.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 31.05.2013 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore

Baza e kundërshtimeve të KEK-ut të theksuara në ankesë është për faktin se Departamenti i faturimit ka bërë korrigjimet siç janë: korrigjimi nr. 15505 i datës 25.03.2008 (-30.82€), korrigjimi nr. 20517 i datës 23.03.2009 (-41.62€), korrigjimi nr. 32767 i datës 20.04.2011 (98.62€) dhe korrigjimi nr. 35000 i datës 17.06.2011 (-6.36€). Po ashtu theksohet se kontestojnë deklaratat e konsumatorit se shume herë ka parashtruar ankesë për kontestim pasi që as çdo kërkesa punëtorët janë dalur në teren për verifikim. Në ankesë theksohet se DMK ka bërë tejkalim të kërkesës së konsumatorit meqë që objekti i shqyrtimit i cili është parashtruar në DMK, i njëjti nuk ka kërkesë në organin e parë të shqyrtimit dhe se shihet qartë se për cilat fatura ka bërë ankesë.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28 qershor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se Departamenti i Faturimit në KEK në muajin shtator 2007 e ka ngarkuar konsumatorin me faturë mujore të energjisë elektrike me shpenzim prej 2968 kWh apo llogaritur financiarisht në vlerë prej 184.80€; në muajin janar 2008 e ka ngarkuar konsumatorin me faturë mujore të energjisë elektrike me shpenzim prej 2555 kWh apo llogaritur financiarisht në vlerë prej 167.58€; në muajin qershor 2008 e ka ngarkuar konsumatorin me faturë mujore të energjisë elektrike me shpenzim prej 2671 kWh apo llogaritur financiarisht në vlerë prej 181.37€; në muajin shkurt 2009 e ka ngarkuar konsumatorin me faturë mujore të energjisë elektrike me shpenzim prej 2717 kWh apo llogaritur financiarisht në vlerë prej 251.46€; në muajin dhjetor 2010 e ka ngarkuar konsumatorin me faturë mujore të energjisë elektrike me shpenzim prej 5116 kWh apo llogaritur financiarisht në vlerë prej 509.18€.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit me shifër DPR – 2001084 dhe ka konstatuar se mesatarja mujore e shpenzimit prej momentit të vendosjes së njehsorit dixhital nr. 202199 (02/2007 – 03/2011) duke mos i marrë në llogaritje faturat e kontestuara është 436 kWh, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike prej 03/2011 e deri më 03/2013 ka qenë 386 kWh/muaj. Sipas kësaj vërehet se me njehsorin e ri elektrik nr. 47442547 në krahasim me njehsorin e vjetër nr. 202199 ka një rënie të shpenzimit prej 13%. Po ashtu është analizuar edhe shpenzimi i energjisë elektrike për periudhat për të cilat KEK-u e ngarkon me fatura mujore të energjisë elektrike: fatura 09/2007 prej 2968 kWh/muaj; fatura 01/2008 prej 2555 kWh, fatura 06/2008 prej 2671 kWh; fatura 01/2009 prej 2717 kWh dhe fatura 12/2010 prej 5116 kWh dhe gjatë analizimit është vërejtur se këto fatura të energjisë elektrike nuk janë reale, pasi që për të njëjtat periudha kohore me njehsor të ri elektrik nr. 47442547 shpenzimi i energjisë elektrike është dukshëm më i ulët, si 06/2011 prej 425 kWh, 09/2011 prej 263 kWh dhe 12/2011 prej 454 kWh.

Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se konsumatori me datë 16.10.2007, 24.09.2008, 02.12.2009 dhe 13.04.2011 ka parashtruar ankesë në KEK dhe se KEK-u është dashur që t'i përgjigjet konsumatorit me shkrim me gjitha analizat e bëra rreth lëndës së konsumatorit e jo vetëm t'i bëjë korrigjimet e disa faturave, pasi që është edhe obligim ligjor t'i kthehet përgjigja konsumatorit në ankesa e parashtruar sipas Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë. Bordi i ZRRE-së thekson se DMK i është përgjigjur konsumatorit në ankesat e parashtruar nga konsumatori dhe se ka bërë një analizë të lëndës së konsumatorit.



Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEK në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, gjithashtu kundërshtimet të theksuara në ankesë kanë shumë kundërthënie njëra me tjetrën, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.06.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK\_V\_933\_04\_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

**IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar